



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës

04.Nr. 62 - 8731 /16

Kaçanik, 11.03.2016

Në mbështetje të Vendimit të Kuvendit të Komunës 01.Nr.400-4738/16 për Ndarjen e Bursave të Studentëve të Komunës së Kaçanikut për Vitin Akademik 2015/2016, Rregullores për Ndarjen e Bursave për Studentë të Komunës së Kaçanikut 01.Nr.16-1846/2013, si dhe Plotësim-ndryshimin e Rregullores Nr.16-1846/2013 për Ndarjen e Bursave për Studentë të Komunës së Kaçanikut 01.Nr.16-10142/15, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, shpall:

KONKURS PËR NDARJEN E BURSIVE PËR VITIN AKADEMIK 2015-2016

1. Komuna e Kaçanikut ndan bursa për studentë të rregullt për studime themelore .

Për të aplikuar për bursë, studentët duhen t'i plotësojnë këto kushte:

- 1.1. të jenë banorë rezident të Komunës së Kaçanikut,
- 1.2. të jenë studentë të rregullt, por jo me vet financim,
- 1.3. të kenë dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak,
- 1.4. të jenë studentë të vitit të dytë e me lartë,
- 1.5. të mos jenë përsëritës të vitit,
- 1.6. të kenë notën mesatare 7,50 e më lartë, përveç studentëve të profileve deficitare, dhe
- 1.7. të jenë studentë të Universiteteve Publike .

2. Studentët të cilët i plotësojnë kushtet nga pika (1) e këtij konkursi duhet t'i paraqesin këto dokumente:

- 2.1. certifikata e provimeve të dhëna original dhe kopjen e indeksit,
- 2.2. deklarata e bashkësisë familjare,
- 2.3. dëshmi se është fëmijë: i kategorive të dala nga lufta, i personit me aftësi të kufizuara dhe se është nga familja në skemën sociale, dhe
- 2.4. certifikatën e vendbanimit.

Komuna e Kaçanikut, për vitin akademik 2015 -2016, do të ndan 50 bursa me nga 40 € (euro) në muaj .

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve bëhet në Zyrën e Pritjes të Komunës.

Afati për aplikim është 15 ditë kalendarike, nga dita e shpalljes së këtij konkursi në mjetet e informimit publik.



Drejtori i drejtorisë;
Enver Kamishi